

VENDIM
Nr. 155, datë 7.10.2020

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “MATEO & CO” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “MURASI”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2000 kW, NË LUMIN E CEMIT TË SELCËS, DEGË E LUMIT CEM I BASHKUAR, NË BASHKINË MALËSI E MADHE, QARKU SHKODËR

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.10.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 105/1 prot., datë 23.9.2020, mbi licencimin e shoqërisë “MATEO & CO” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 144, datë 28.8.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “MATEO & CO” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Murasi”, me kapacitet prodhues 2000 kW, në lumin e Cemit të Selcës, degë e lumit Cem i Bashkuar, në Bashkinë Malësi e Madhe, qarku Shkodër, për një afat 30-vjeçar.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 62/27 prot., datë 28.8.2020, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “MATEO & CO” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 1053/2 prot., datë 1.9.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit.

- Me shkresën nr. 52 prot., datë 17.9.2002, protokolluar në ERE me nr. 1053/4 prot., datë 17.9.2020, shoqëria “MATEO & CO” sh.p.k., ka depozituar në ERE dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria “MATEO & CO” sh.p.k., është regjistruar pranë QKB-së në datën 20.5.2016, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” (QKB), me formë ligjore shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

- Shoqëria “MATEO & CO” sh.p.k. ka depozituar në ERE kontratën nr. 1768 rep., nr. 784/3 kol., datë 26.7.2017, “Kontratë për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Murasi’ me kapacitet prodhues 2 mw, në lumin e Cemit të Selcës, degë e lumit Cem i Bashkuar, në Bashkinë Malësi e Madhe, qarku Shkodër, e lidhur midis MIE-s dhe mbajtësit të miratimit, shoqërisë “MATEO & CO” sh.p.k.

- Shoqëria ka depozituar në ERE raportin e oponencës teknike të AKBN-së nr. 2572 prot., datë 20.3.2017, mbi projektin e zbatimit të HEC “Muras”, miratuar nga MIE me miratimin përfundimtar nr. 3719/13, datë 13.7.2017, “Për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë, hidrocentralit ‘Murasi’, në lumin e Cemit të Selcës, qarku Shkodër”.

- Shoqëria “MATEO & CO” sh.p.k., ka përcjellë në ERE shkresën e OSHEE sh.a. 27446/2 prot., datë 21.11.2016, “Miratim pikë lidhje”, drejtuar shoqërisë “MATEO & CO” sh.p.k., ku përcaktohet se HEC-i, do të lidhet me rrjetin shpërndarës në linjës 35 kv, të n/stacionit Tamarë.

- Shoqëria ka paraqitur “Leje për përdorim të burimit ujqor” me nr. serie 00050, nr. 179/10 prot., datë 20.4.2017, të miratuar nga KBU Drin-Bunë, me vendimin nr. 11, datë 10.4.2017, për shoqërinë “MATEO & CO” sh.p.k. me qëllim ndërtimin e HEC “Murasi”, duke përdorur burimin ujqor lumin Cemi i Selcës, degë e lumit Cemi i Bashkuar.

- Shoqëria ka përcjellë në ERE, VNM-në paraprake, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me nr. 2829 prot., datë 2.12.2016 dhe nr. 712 identifikimi dhe nr. 59 vendimi, për personin juridik “MATEO & CO” sh.p.k., “Për të zhvilluar projektin ‘Ndërtim-operim i HEC ‘Murasi’ me kapacitet 2000 kW”.

- Duke qenë se afati i vlefshmërisë së lejes së ujqit me nr. serie 00050, nr. 179/10 prot., datë 20.4.2017, të miratuar nga KBU Drin-Bunë, me vendimin nr. 11, datë 10.4.2017, për shoqërinë “MATEO & CO” sh.p.k., është deri më 9.4.2022, do t’i kërkohet shoqërisë që të depozitojë në ERE lejen e ujqit të rinovuar, pas përfundimit të afatit të sipërcituar.

- Duke qenë se afati i vlefshmërisë së kontratës së qirasë me nr. 6418 prot., datë 8.10.2018, të nënshkruar midis Bashkisë Malësi e Madhe, në cilësinë e qiradhënësit, dhe shoqërisë “MATEO & CO” sh.p.k. në cilësinë e qiramarrësit, përfundon në datën 8.10.2023, do t’i kërkohet shoqërisë në vijim që, pas rinovimit, të përcjellë në ERE kontratën e rinovuar.

Nga analiza e dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “MATEO & CO” sh.p.k., rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i dhe dokumentacioni për aplikim. Neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”. Plotësuar

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor. Neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”. Plotësuar

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c”, “d”. Plotësuar. Shoqëria ka kryer financimin e veprës pjesërisht me të ardhurat e shoqërisë dhe një pjesë me kredi bankare.

- Dokumentacioni teknik për HEC. Neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3, germat “a”, “b”, “c”, “d” dhe pika 4.1.4, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”. Plotësuar.

- Leje nga institucione të tjera. Neni 9, pika 4.1.5, germat “a”, “b”, “c”. Plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “MATEO & CO” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Murasi”, me kapacitet prodhues 2000 kW, në lumin e Cemit të Selcës, degë e lumit Cem i Bashkuar, në Bashkinë Malësi e Madhe, qarku Shkodër, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria “MATEO & CO” sh.p.k. të bëjë me dije ERE-n mbi ecurinë e procesit të rinovimit, si dhe të depozitojë në ERE çdo dokument/leje që i nënshtrohet procedurës së rinovimit, jo më vonë se 1 muaj pas rinovimit të tyre.

3. Mos plotësimi i kushtit të parashikuar në pikën 2, të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e vendimit nga ERE.

4. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti